



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE ISJP-A

Nr. 2129/3 Prot.

Tiranë, më 04.12.2025

URDHËR

Nr. 147, Datë 04.12.2025

PËR

**NJË THIRRJE TË DYTË PËR PERSONEL AKADEMIK ME KOHËZGJATJE TË CAKTUAR DHE ME ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME, NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA DHE FAKULTETIN E MUZIKËS, TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026**

Në zbatim të nenit 3, pika 4, gërma “ç”, nenit 39, pika 12, nenit 57, pika 2, nenit 59 dhe nenit 62 të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të Vendimit të Senatit Akademik nr. 47, datë 01.10.2025 “Për propozimin për miratimin e kriterëve të vlerësimit të kandidatëve për personelin akademik me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe angazhim me kohë të pjesshme, në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2025-2026”, të Vendimit të Senatit Akademik nr. 46, datë 01.10.2025 “Për propozimin për miratimin e numrit të personelit akademik me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe angazhim me kohë të pjesshme, në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2025-2026”, të Vendimit të Senatit Akademik nr. 54, datë 14.11.2025 “Për miratimin e personelit akademik me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme, në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2025-2026”, si dhe në shkresën nr. 2129/2 prot., datë 02.12.2025 të DMBNJ JSIP-A, nëpërmjet së cilës përcillet kërkesa për miratim për pozicionet vakante për pedagog të jashtëm sipas kërkesës së Fakultetit të Arteve të Bukura dhe Fakultetit të Muzikës,

URDHËROJ:

1. Njësitë bazë në fakultetet e Universitetit të Arteve kanë të drejtë të kërkojnë të punësojnë personel akademik për veprimtari të mësimdhënies, me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme.
2. Për zgjedhjen e personelit akademik me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme ngrihen komisione *ad hoc*, në fakultetet e UART, duke iu përmbajtur rregullave të përgjithshme, si më poshtë vijon:



- a. Shpallja e vendeve të lira, sipas kërkesave të fakulteteve të Universitetit të Arteve, bëhet nga Rektorati i Universitetit të Arteve, pasi janë miratuar në Senatin Akademik;
  - b. Njoftimi i shpalljes së vendeve të lira bëhet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ISJ/P-A;
  - c. Komisionet *ad hoc* pranë fakulteteve, ngrihen me urdhër nga dekani i fakultetit;
  - d. Komisioni *ad hoc*, si rregull, përbëhet nga pesë anëtarë të cilët janë:
    - Drejtuesi i njësisë kryesore Kryetar;
    - Drejtuesi i njësisë bazë Anëtar;
    - Një anëtar nga personeli akademik me dije në fushën për të cilin zhvillohet konkursi, përcaktuar nga përgjegjësi i njësisë bazë, miratuar nga dekani/drejtuesi i njësisë kryesore.
    - Prof. Asoc. Dorian Çene Anëtar (dërguar nga Rektorati);
    - Z. Meris Xibraku Anëtar (dërguar nga Rektorati);
3. Komisioni *ad hoc* organizon, drejton dhe mbikëqyr procedurat e zhvillimit të konkurrimit, shqyrton dosjet dhe vlerëson me pikë kandidaturat e paraqitura mbi bazën e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për secilin specialitet, të publikuara dhe të shpalluara publikisht nga Rektorati i UART;  
Kryetari dhe anëtarët e komisionit *ad hoc* janë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit, duke filluar që nga marrja në dorëzim e dosjeve të kandidatëve, zhvillimi i konkurrimit e deri në shpalljen e vendimit për vlerësimin, renditjen dhe përzgjedhjen e kandidatëve.
  4. Komisioni *ad hoc*, duhet të përfundojë procedurën e konkurrimit përcaktuar në urdhër brenda datës 11.12.2025. Konkursi pranë Fakultetit të Arteve të Bukura dhe Fakultetit të Muzikës do të zhvillohet më datë 11.12.2025.
  5. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ISJ/P-A ndihmon komisionin *ad hoc*, mbikqyr dhe kontrollon zhvillimin e procedurave të konkurrimit në përputhje me aktet e zbatueshme, si dhe njofton periodikisht rektorin për ecurinë e tyre. Në rastet kur vërehen shkelje, kjo drejtori njofton menjëherë rektorin, i cili mund të vendosë pezullimin e procedurave. Në përfundim të konkurrimit DMBNJISJ/P-A i paraqet rektorit një raport me shkrim mbi zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
  6. Çdo anëtar i komisionit *ad hoc* është i detyruar të shqyrtojë në mënyrë individuale të gjitha dosjet e prezantuara për konkurrim. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kandidatëve, komisioni *ad hoc* merr vendim për kualifikimin ose jo të kandidatëve, duke bërë renditjen e përgjithshme të kandidatëve, mbi bazën e pikëve të fituara.
  7. Vendimet e komisionit *ad hoc* merren me shumicë votash. Anëtarët nuk lejohet të abstenojnë.
  8. Në përfundim të procesit, kryetari i komisionit përpilon procesverbalin dhe i paraqet rektorit listën e kandidatëve sipas renditjes me pikë.

9. Rektori, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga komisioni *ad hoc*, merr vendim dhe shpall fituesit.
10. Lista e kandidatëve fitues afishohet në ambientet e Universitetit të Arteve dhe në faqen e WEB.
11. Brenda 5 ditëve nga shpallja e kësaj liste, kandidatët konkurrentë mund të ankohen pranë rektorit për renditjen e pikëve të shpallura nga komisioni *ad hoc*. Në këtë rast, si dhe në rastet kur rektori e çmon të nevojshme verifikimin e procedurave të konkurrimit, dekani i fakultetit i paraqet rektorit dosjen e plotë të konkursit.
12. Në rastet e përcaktuara më lart, rektori shqyrton dosjen e konkurrimit dhe vendos sipas rastit:
  - a. Të mos pranojë ankimin;
  - b. Të kthejë dosjen e konkursit për rivlerësim;
  - c. Të anulojë konkursin.
13. Pas shpalljes së vendimit, mbështetur në ligjin nr. 80/2015 dhe në Kodin e Punës, kandidatët lidhin kontratë pune me Universitetin e Arteve. Kontrata nënshkruhet nga punëmarrësi dhe punëdhënësi (rektori), pasi lista emërore e kandidatëve fitues për çdo fakultet të jetë miratuar nga Senati Akademik.
14. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri zëvendësrektori për anën mësimore, dekanët dhe drejtuesit e njësive bazë në fakultete si dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ISJ/P-A.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

REKTORI

Prof. Dr. Erald Bakalli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE JSIP-A

Nr. 2129/Prot  
/2

Tiranë, më 02/12/2025

**Lënda: Kërkesë për miratim për pozicionet vakante për pedagog të jashtëm sipas kërkesës së Fakultetit të Arteve të Bukura dhe Fakultetit të Muzikës.**

REKTOR  
Prof.Dr.Erald BAKALLI

I nderuar,

Në vijim të kërkesës së Fakultetit të Arteve të Bukura protokolluar me shkresën Nr 2119 prot, datë 26.11.2025, si dhe kërkesës së Fakultetit të Muzikës protokolluar me shkresën Nr.2129 prot, datë 27.11.2025, në të cilën kërkojn shpallejn e konkursit për personel akademik me kohëzgjatje të caktuar për lëndët si më posht:

**Fakulteti i Arteve të Bukura:**

- 1.Njohuri Arkitekture
- 2.CAM CAD

**Fakulteti i Muzikes**

- 1.Dirizhim

Gjithashtu në vijim Fakulteti i Arteve të Bukura kërkon staf akademik me kohëzgjatje të caktuar për vitin 2025-2026 për lëndë të tjera, për të cilat kërkohet miratimi i numërit të stafit akademik me kohëzgjatje të caktuar nga Senati Akademik, konkretisht për lëndet:

- 1.Njohuri 3D
- 2.Konservim Restaurim
- 3.Teknikat e pikturimit

*Bashkëlidhur gjeni kërkesat e Fakulteteve mbi nevojat për staf akademik me kohëzgjatje të caktuar.*



Drejtor i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore JSIP-A

Meris XIBRAKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE, TIRANË  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA

DEPARTAMENTI I PIKTURES

Nr. Prot. 2119

Datë: 26.11.2025

**Lënda:** Mbi miratimin e listës së pedagogëve të ftuar për vitin akademik 2025 – 2026.

**Drejtorisë së Burimeve Njerëzore**

**Z.Meris Xibraku**

**K Ë R K E S Ë**

Bazuar në vendimin e Senatit mbi “Miratimin e Personelit Akademik me Kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe angazhim me kohë të pjesshme në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2025-2026 si dhe miratimin e numrit për pedagogë të ftuar, referuar nevojave të Fakultetit konstatohet që kërkesa jonë për pedagogë të ftuar e tejkalon numrin e miratuar nga Senati Akademik.

Në këto kushte jemi të detyruar të dakortësojmë vetëm 2 vende për lëndët:

1. Njohuri Arkitekture
2. CAM CAD

Kërkojmë shqyrtimin e kërkesës sonë për personel akademik me kohë të pjesshme për 3 lëndët:

1. Kompjuter 3D
2. Konservim Restaurim
3. Teknikat e pikturimit



Me respekt,

**Dekan i FAB**

**Prof. Sadik Spahija**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I MUZIKËS

Nr. 22<sup>8</sup> Prot.

Tiranë, më 27/11/2025

Lënda : Propozim për personel akademik me kohë të pjesshme

DREJTORI I DREJTORISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE  
NJERËZORE/SJIP/A

Bashkangjitur do te gjeni shkresën e Departamentit KMDP, për propozim për personel akademik me kohë të pjesëshme.

DEKANI

  
Prof. Arben LLOZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I MUZIKËS  
DEPARTAMENTI I KMDP-së

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 27.11.2025

**Lënda:** Propozim për personel akademik me kohë të pjeshme.

**Drejtuar:** DEKANIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE  
Prof.Arben Llozi

Bazuar në statutin e Uart nr.15, datë 30.08.2021, neni 57 pika 1, për nevojat e departamentit të KMDP-së ju propozoj, për personel akademik me kohë të pjeshme në grupin e dirizhimit për dhënie të lëndës special dirizhim nga kategoria profesor.

Faleminderit për mirkuptimin.

PËRGJEGJËSI I DEPARTAMENTIT TË KMDP-së

Prof.Petrika Afezulli

